

VENDIM
Nr. 200, datë 16.3.2016

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË SHETIT TË KUVAJTIT, NË FUSHAT E SHËNDETIT PUBLIK DHE
SHKENCAVE MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndër-kombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit, në fushat e shëndetit publik dhe shkencave mjekësore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË TË SHETIT TË KUVAJTIT NË FUSHAT E SHËNDETIT PUBLIK DHE
SHKENCAVE MJEKËSORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga “Ministria e Shëndetësisë” dhe qeveria e shtetit të Kuvajtit, përfaqësuar nga “Ministria e Shëndetësisë”, që më pas do t’i referohemi si “Palët”;

me vullnetin për të përforcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve të tyre në fushat e shëndetit publik dhe shkencave mjekësore, si edhe në përputhje me ligjet dhe rregullat e secilit vend;

kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Në përputhje me legjislacionin e brendshëm të të dyja vendeve, Palët do të përforcojnë dhe do të zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetit publik dhe shkencave mjekësore, mbi bazën e reciprocitetit dhe përfitimit të përbashkët.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

Palët kanë rënë dakord për të zhvilluar bashkëpunimin në fushat e mëposhtme me interes reciprok:

1. Shkëmbim të ekspertëve dhe pjesëmarrje në programe trajnimi;
2. Trajnim dhe edukim të vazhdueshëm të stafit mjekësor;

3. Bashkëpunim në fushën e infermieristikës;
4. Shkëmbim informacioni për politikat shëndetësore dhe planet zhvillimore në sektorin e shëndetësisë;
5. Fusha të tjera bashkëpunimi me interes të përbashkët, që mund të shtohen me rënien dakord të Palëve.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit

Të dyja Palët do të punojnë për të thjeshtuar shkëmbimin e informacionit dhe vizitat e delegacioneve dhe ekspertëve, si edhe pjesëmarrjen në konferencat mjekësore, kongreset dhe *workshop*-et e organizuara në secilin nga vendet, në një nga fushat e bashkëpunimit, siç është rënë dakord në këtë Memorandum.

Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me kërkesat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, me legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve, si edhe me detyrimet ndërkombëtare, me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat shtetet janë Palë dhe pa paragjykime për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

Neni 4

Detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare

Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me kërkesat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, me legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve, me detyrimet ndërkombëtare të tyre, si edhe me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat shtetet janë Palë dhe pa paragjykime për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë për shkak të interpretimit ose zbatimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negociatave direkte, ndërmjet Palëve dhe nëpërmjet kanaleve diplo-matike.

Neni 6

Rregullimet financiare

Me përjashtim të rasteve të veçanta, Palët bien dakord midis tyre, rast pas rasti, ku secila Palë do të financojë pjesën e saj të shpenzimeve, që rezultojnë nga aktivitetet e bashkëpunimit, të zhvilluara në përmbushje të këtij memorandumi.

Neni 7

Amendimi

Këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund t'i bëhen amendime në rastet kur bien dakord me mirëkuptim reciprok dhe amendimet do të konsiderohen pjesë integrale e mëtejshme e Memorandumit, amendimet do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të përmendura në paragrafin 1 të nenit 8.

Neni 8

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi që nga data e njoftimit të fundit, ku njëra nga Palët informon me shkrim Palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se i ka përmbushur procedurat institucionale për hyrjen e tij në fuqi.

2. Ky Memorandum Bashkëpunimi do të vazhdojë të qëndrojë në fuqi për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare) dhe do të rinovohet auto-matikisht për periudha të tjera pesëvjeçare, me përjashtim kur njëra nga Palët shpreh dëshirën për ta përfunduar atë me anë të një njoftimi me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj para datës së skadimit të afatit të vlefshmërisë.

3. Përfundimi i këtij Memorandumi Bashkë-punimi nuk do të ndikojë në implementimin e aktiviteteve të bashkëpunimit për të cilat është rënë dakord, para datës së përfundimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi.

Lidhur në qytetin e Kuvajtit, më 19 nëntor 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, të gjitha tekstet do të jenë njëlloj autentike. Në rast kundërshtie në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

PËR QEVERINË E SHITETIT TË KUVAJTIT
ZËVENDËSKRYEMINISTRI I PARË DHE MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME
Sabah Khaled Al-Hamad Al-Saba